

VENDIM
Nr. 708, datë 6.11.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH
TË MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR ASISTENCË TEKNIKE, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT
TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E
PËRGATITJES SË NJË STUDIMI FIZIBILITETI PËR PROJEKTE TË
INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT NË ZONAT BREGDETARE JUGORE
TË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 500, DATË 29.8.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit për asistencë teknike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 500, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FONDI KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/11 G 6 - 151	Numri total i faqeve: 1	
Data: 30.10.2018	Administrata & Operacionet	CF: AB/45/PY
Faks: (965) 22999190	Telefon: (965) 22999000	Faqja e internetit:
(965) 22999091	Email: operations@kuwait-fund.org	http://www.kuwait-fund.org
Drejtuar: Z. Arben Ahmetaj	Faks/email:	
Ministër i Financave dhe Ekonomisë	+355 42 228494	
Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Tiranë, Republika e Shqipërisë		

Lënda: Asistenca teknike për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë – K.F. Granti nr. 365

Ju njoftojmë, me falënderime, se e kemi marrë letrën tuaj me prot. nr. 18184, të datës 10 tetor 2018, në të cilën kërkuat një shtyrje afati të së drejtës suaj për të kryer tërheqje nga Asistenca Teknike e lartpërmendur, afat i cili përfundon më 31 dhjetor 2018.

Kemi kënaqësinë t’iu njoftojmë, shkëlqesia juaj, se kjo e drejtë do të shtyhet deri më 31 dhjetor 2020.

Duke ju siguruar, shkëlqesia juaj, për bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni urimet tona më të përzemërta.

Marwan Al-Ghanem
Zëvendësdrejtör i Përgjithshëm i Operacioneve
13030 2921 Faks: (965) 22999090/22999091 Tel: (965) 22999000
P.O.Box: 2921 Safat, 13030 Kuwait Email: info@kuwait-fund.org Faqja e internetit:
www.kuwait-fund.org